

V E N D I M  
I G J Y Q T A R I T T E V E T Ë M

Sot me date 08.12.2006, Unë A. Gumborollu (Coco) gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e zotit Sulejman Lala, me cilësinë e Administratorit të shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, për depozitimin e dokumenteve të kësaj shoqërie pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Tiranë. Pasi shqyrtova kërkesën e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqëria "KATËR GRYKËT" sh.p.k është person juridik shqiptar, e regjistruar në regjistrin e Shoqërive Tregtare, me vendimin Nr. 1147, datë 28.01.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Me vendimin nr.7, date 01.12.2006 të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k është vendosur:

- Miratimi i raportit për rritjen e kapitali themeltar të shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, përpiluar nga eksperti Vera Lala.
- Rritja e kapitalit të shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, nga fitimet e vitit financiar 2005 dhe rezervave në shumën 39.407.106 (tridhjetë e nënte milion e katerqind e shtate mije e njëqind e gjashtë) Lekë.

*Pas rritjes së mësipërme kapitali i nënshkruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, bëhet: 65.000.000 (gjashtëdhjete e pesë milion) Lekë i ndare në 100 kuota me vlerë nominale 650.000 (Gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) Leke secila.*

- Të depozitohet raporti i ekspertës Vera Lala, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Rrethit Tiranë.
- Të depozitohet ky vendim në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranë autoriteteve kompetente përkatëse tatimore, duke ngarkuar për këtë z. Sulejman Lala në cilësinë e administratorit.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij dhe çmova se ajo është e drejte dhe e bazuar në ligj, si e tille duhet pranuar,

P E R K E T O A R S Y E

Dhe në baze të ligjit 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të ligjit 7667 date 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
  - Depozitimin e Vendimit Nr.7/01.12.2006, të Asamblesë së Ortakut të Vetëm shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k me të cilin është vendosur:
    - Miratimin e raportit për rritjen e kapitali themeltar të shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, përpiluar nga eksperti Vera Lala.
    - Rritjen e kapitalit të shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, nga fitimet e vitit financiar 2005 dhe rezervave në shumën 39.407.106 (tridhjetë e nënte milion e katerqind e shtate mije e njëqind e gjashtë) Lekë.
- Pas rritjes së mësipërme kapitali i nënshkruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë "KATËR GRYKËT" sh.p.k, bëhet: 65.000.000 (gjashtëdhjete e pesë milion) Lekë i ndare në 100 kuota me vlerë nominale 650.000 (Gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) Leke secila.*
- Të depozitohet raporti i ekspertës Vera Lala, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Rrethit Tiranë.
  - Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

G J Y Q T A R E

Ariena Gumborollu (Coco)  
